



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

---

Nr. 513/ 3 Prot.

Tiranë, më 30/09/2017

**V E N D I M**

**Nr.138, Datë 30/09/2017**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t, SARANDË “MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROÇEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE”**

Pasi u njoha me Raportin përfundimtar të auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga drejtori i departamentit të auditimit të mësipërm, Drejtorit Përgjithshëm në mbështetje të neneve 10, 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Sarandë, për periudhën nga data 01.03.2014-30.06.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 709/14, datë 26.11.2013, “Kërkesë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e fundit”, bazuar në

nenin 15 “Të drejtat e detyrat e KLSH-së” dhe nenin 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në lidhje me Raportin përfundimtar të auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse, ka kërkuar zbatimin e rekomandimeve, konkretisht: “Masa shpërblim dëmi nr. 1, pika b, në **10 raste** për sipërfaqen **15216 m<sup>2</sup>** arkëtuar më pak shuma **9,696,089 lekë**, si diferencë e pagesës së sipërfaqes së parcelës ndërtimore të paguar, me sipërfaqen e vetë deklaruar të përcaktuar në VKM dhe që zotëron poseduesi i ndërtimit informal në fakt, sipas dosjeve. Kanë ndarë parcelën ndërtimore, e cila si e tillë duhet shitur me vlerën e tregut, për rrjedhojë i kanë shkaktuar një dëm buxhetit të shtetit për fondin e kompensimit të ish pronarëve” (këto sipërfaqe në asnjë rast nuk mund të parcelizohen (trajtuar në faqet, 28-32,46-62, të Raportit Përfundimtar të Auditit), të njoftohet ZVRPP Sarandë dhe ZQRPP për vendosjen e barrës (shënim hipotekor), deri në shlyerjen e detyrimit të nxjerrë” që në momentin e auditimit rezulton i pa zbatuar .

**1.1. Rekomandim:** Për të gjithë poseduesit e lejeve të Legalizimit të trajtuara në faqet 19-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar me shkresën nr. 709/14, datë 26.11.2013, të cilat kanë rezultuar me detyrime në mos llogaritjen e saktë të tarifës së parcelës ndërtimore, të njoftohet ZVRPP Sarandë dhe ZQRPP për vendosjen e barrës (shënim hipotekor) deri në shlyerjen e detyrimit të nxjerrë.

*Menjëherë*

**2. Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNIT Sarandë, për periudhën 2015 nuk ka hapur librat e kontabilitetit për regjistrimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre sipas kapitujve, titujve, si ditarët analitik, libri i madh apo centralizatori. Për pasojë të gjitha veprimet janë kryer nga jashtë, me programin excel, veprim në kundërshtim me pikën 100 e 101 të kapitullit II. 3 “Buxhetit vendor” të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” .

**2.1 Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI-t Sarandë, të organizoj mbajtjen e kontabilitetit sipas një programi të caktuar duke hapur librat e kontabilitetit për regjistrimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre sipas kapitujve, titujve, si ditarët analitik, libri i madh apo centralizatori.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNI-t Sarandë, sektori i financës rezulton se nuk ka rakorduar me degën e thesarit të rrethit për çdo muaj, mbështetur në udhëzimin nr 2 datë 6.02.2012 të Ministrisë Financave për zbatimin e buxheteve të viteve ushtrimore .

**3.1- Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI-t Sarandë, sektori i financës të marrë masa të menjëhershme zbatojë me korrektesë udhëzimin e lartpërmendur pika 172, nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin dhe pika 173.

*Menjëherë*

**4. Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNIT Sarandë sipas auditimit rezulton, se në dosjet e personelit, dokumentacioni i punonjësve është fotokopje dhe i pa noterizuar. Gjithashtu dosjet e personelit nuk janë të pajisura me inventar dhe të protokolluara mbi përmbajtjen e tyre në përputhje me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrin të personelit” aneksi I dhe II .

**4.1- Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNIT Sarandë të marrë masat që të gjitha dosjet e personelit të plotësohen me dokumentacion origjinal apo fotokopje të noterizuara, duke bërë dhe inventarizimin e tyre si dhe mbajë librat e pagave për çdo punonjës.

*Menjëherë*

**5. Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNIT Sarandë, nuk ka hartuar plan vjetor dhe nuk ka bërë përlllogaritje të fondit limit në asnjë prej 12 procedurave për blerjet me vlera të vogla gjatë periudhës 2016-30.06.2017. Fondi i prokuruar i referohet buxhetit të miratuar të institucionit. Në disa raste testimi i tregut është bërë pasi është përcaktuar fondi limit për objektin që do të prokurohet, duke mos bërë përlllogaritjet e tij, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, neni 9, pika 1, dhe udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

-Gjithashtu në Drejtorinë e ALUIZNIT Sarandë nuk është ngritur komision për kolaudimin dhe marrjen e mallrave, punimeve dhe shërbimeve në dorëzim, në të gjitha procedurat mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave ose kryerjes së shërbimit, veprime në kundërshtim me pika 42, 43, 52 dhe 60, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**5.1- Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNIT Sarandë, sektori i financës dhe komisioni i ngritur për prokurimin e blerjeve me vlera të vogla, të marrë masa për përlllogaritjen e saktë të fondit limit, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, të ngrihet komision për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave, punëve apo shërbimeve në zbatim me pikat 42, 43, 52 dhe 60, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t Sarandë gjatë periudhës 01.03.2014-30.06.2017, është proceduar me daljen nga arshiva i **3816 dosjeve** për azhurnim ose 37 % e totalit të vetë deklarimeve prej 10078, nga të cilat; 1453 dosje objektsh janë raportuar në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t me procedura terreni dhe dokumentare të përfunduara, (pasi janë kryer matjet, genplanet, planimetri, është tërhequr informacion nga ZVRPP, Procesverbalet e Konstatimit, Akt kualifikimit si dhe Vendimet e Kualifikimit) dhe 1853 dosje objektsh janë rikthyer në arshivë, pa u dokumentuar mbi përfundimin apo jo të procedurave të terrenit dhe dokumentare, pa u dokumentuar arsyet e rikthimit në arshivë, dhe pa u selektuar më parë si subjekte që duheshin skualifikuar apo jo, veprime këto që vinë në kundërshtim me pikën 5 të nenit 2, neni 38 dhe neni 39-*Përrjashtimi nga Legalizimi*, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, kapitulli IV i VKM nr. 280, datë 01.04.2015, urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 ndryshuar me 954, datë 25.11.2015 .

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Sarandë të marrë masa, për të gjitha objektet informale të cilat janë përditësuar e nuk plotësojnë kriteret për legalizim, **të ndiqen procedurat, për skualifikimin e tyre nga procesi i legalizimit dhe të njoftohen aplikuesit si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në rang qarku, për tu trajtuar si ndërtime të paligjshme që nuk përfshihen në legalizim.**

*Deri më datë 31.12.2017*

**7. Gjetje nga Auditimi:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Sarandë gjatë periudhës 01.03.2014-30.06.2017, në **940 raste** në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –**“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”** si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”, kreu I, pika 1,c ku përcaktohet :...“ c) për

*objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë bashkive në rang qarku vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 38,228,821 lekë**.*

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, duke kërkuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në rang qarku vërtetimet mbi llogaritjen e likuidimit e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **940** rastet në **vlerën prej 38,228,821 lekë**.

*Brenda datës 30.12.2017*

**8. Gjetje nga Auditimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Sarandë gjatë periudhës 01.03.2014-30.06.2017, nuk ka administruar dokumentacionin shkresor për skualifikimin ose jo të **45 objekteve të ndërtuara në zonën historike, turistike, arkeologjike A, si dhe për 97 objekte të ndërtura në zonën e mbrojtjes mjedisore “A” Parku Kombëtar i Butrintit** miratuar me VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen kompleksit ligatinor të Butrintit- Park Kombëtar” ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.02.2013. Nuk disponohet dokumentacioni për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore, veprime në kundërshtim me neni 38 “Dhënia e lejes së legalizimit” dhe nenin 39 të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 i ndryshuar.

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë të marrë masa që në procesin e legalizimit të objekteve informale të dokumentojë në një regjistër të veçantë objektet e ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin, duke informuar në çdo rast Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe **të gjitha institucionet e vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave për prishje të objekteve të përjashtuara nga procesi i legalizimit**.

*Deri më datë 31.12.2017*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në **75 raste**, dokumenti i “Proces verbalit të verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë, por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal. Nuk janë pasqyruar; ndërtimi në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti tek kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve, veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet” i ndryshuar.

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë të marrë masa, që për **75 rastet** e konstatuara në vijim të plotësohet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Në rastin e mos plotësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

*Deri më datë 31.12.2017*

**10. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast gjatë vitit 2016, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë nuk ka respektuar afatin 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, veprime këto në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8 “*Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit të paraqitura grafikisht*” .

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë, të marrë masa që më plane konkrete të shqyrtojë kërkesat për të zbatuar afatet ligjore për shqyrtimin e praktikave të legalizimit në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8”.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë, në **75 raste** gjatë periudhës 01.03.2014-30.06.2017, nuk disponon në dosje dokumentacionin që të pasqyrojë **periudhën e ndërtimit pa leje, pjesën e shtesës pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit dhe kohën ndërtimit**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 “Procedura për fillimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje”, neni 45/ “Dispozita kalimtare” pika nr. 1 ku përcaktohet: - “Për ndërtimet pa leje, të ngritura sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 2, të këtij ligji, ALUIZNI kryen evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren. Në funksion të kësaj procedure përdoret harta vektor dhe ortofoto e përftuar nga imazhi satelitor, që disponohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përcaktimi i periudhës kohore, brenda së cilës janë ndërtuar objekte pa leje, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave”, si dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo", kapitulli i I-rë "Kriteret dhe dokumentacioni i zbatueshëm për legalizimin e ndërtimit pa leje" .

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë, të marrë masa që për **75 rastet** e konstatuara me mungesë në dokumentacionin që të pasqyrojë **periudhën e ndërtimit pa leje, pjesën e shtesës pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit dhe kohën ndërtimit**, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për rishikimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

*Deri më datë 31.12.2017*

**12. Gjetje nga auditimi:** Në **49 raste** gjatë periudhës 01.03.2014-30.06.2017, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:

- Në **9 raste për sipërfaqen prej 2674 m<sup>2</sup>**, rezultoi se sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Sarandë, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, ullishte, pemëtores”, zona jo informale, pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të

cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimit të zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, **duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall”**.

- **Në 3 raste**, për dosjet nr. 1441/1, datë 04.11.2014, leje legalizimi nr. 1040010, datë 29.10.2015, godinë banimi 2 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: S.Z.Z, me adresë Borsh, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, ZK. 1253; nr. 57, datë 04.09.2006, leje legalizimi nr. 1040001, datë 10.10.2015, godinë e kombinuar 4 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: S.T.J me adresë Shkallë Borsh, ZK. 1253; nr. 11, datë 15.09.2006, leje legalizimi nr. 1040006, datë 22.10.2016, godinë banimi 1 kat, pronar i ndërtimit pa leje: S.I.K me adresë lagje Haliq, Borsh, ZK. 1253. Drejtoria e ALUIZNI Sarandë ka miratuar leja e legalizimit për këto objekte ndërkohë që për zonën e Borshit, si pjesë e vijës bregdetare nuk lejohet legalizimi i objekteve deri në hartimin e planit të integruar sektorial për vijën bregdetare, veprime këto që bien në kundërshtim me vendimin e KKT-së nr. 1, datë 08.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të Planit të integruar sektorial për brezin bregdetar”, pika 1, 1.1, 2, 4 dhe 6.

- **Në 9 raste** rezultoi se **janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet**, ku sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës së detit me pak se 100 metrash** veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar, ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, nenin 4, pika 8 a dhe b, VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” , pika 4.

- **Në 17 raste** nga verifikimi materialit dixhital e hartografik, gent plan, ortofoto **rezulton se** nga Drejtoria e ALUIZNI-t Sarandë janë pajisur me leje legalizimi objekte të ndërtuara **brenda zonës së mbrojtjes mjedisore “A” Parku kombëtar i Butrintit** miratuar me VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “ Për shpalljen kompleksit ligatinor të Butrintit- Park kombëtar” ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.02.2013, administruar në ALUIZNI Sarandë me nr. 152 prot, datë 28.02.2013, për pasojë këto objekte nuk duhet të kualifikoheshin dhe nuk duhet të procedohej me dhënien e lejes së legalizimit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, kreu II “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve brenda zonave informale të miratuara”, pika 2/d, si dhe ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 27.

- **Në 2 raste** për dosjet nr. 1849/1, datë 11.12.2014, leje legalizimi nr. 1040131, datë 23.08.2016, godinë banimi 5 kate, pronar i ndërtimit pa leje: V.K dhe dosja nr. 432, datë 16.01.2016, leje legalizimi nr. 1040043, datë 07.05.2016, godinë e kombinuar 5 kat, pronar i ndërtimit pa leje Kosta P.D, rezultoi se nga ALUIZNI Sarandë është proceduar me dhënien e lejes së legalizimit për objektet mbi 4 kate pa u administruar më parë në dosje akt-ekspertiza për ndërtimin mbi 4 kat në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar, neni 27, germa “e” ku përcaktohet se: *“Akt-ekspertizë nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit, për ndërtimet me lartësi mbi 4 kate”*, kjo verifikuar dhe me fletë inventarin bashkangjitur dosjes.

- **Në 2 raste**, për dosjet si vijon:

- **Nr. 2303, datë 13.11.2006**, leje legalizimi nr. 1040154, datë 19.09.2016, “Godinë e kombinuar 2 kat”, pronar i ndërtimit pa leje Z.V,

- **Nr. 693/1, datë 17.10.2006**, me kërkues E.S.P me adresë Ksamil, Sarandë për deklarin e ndërtimit informal në pronë shtet, me sipërfaqe të zënë 1000 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 144 m<sup>2</sup>, një kat, **rezulton se** nga ALUIZNI Sarandë është procedura me dhënien e lejes së legalizimit, pa u ankimuar vendimet e gjykatave të shkallës së parë, të cila kanë marrë formë të prerë pas kalimit të afateve të ankimit, veprime këto që vinë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar; Rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit.

- **Në 1 rast** është miratuar leje legalizimi në **Zonën “B” Muzeale** dhe konkretisht **Dosja nr. 100, datë 18.06.2013**, leje legalizimi nr. 1040149, datë 31.08.2016, “Godinë e kombinuar 4 kate”, pronar i ndërtimit pa leje V., A & J.L.G, me adresë lagje nr. 3 Sarandë, ZK nr. 8641, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 320 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 102 m<sup>2</sup>, për banim 414 m<sup>2</sup>, për aktivitet 102 m<sup>2</sup>, pasuria nr. 7/25, kjo pronësi rezulton e regjistruar në ZVRPP Sarandë sipas çertifikatës nr. 1416621, datë 16.05.2016, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, sipërfaqja prej 20 m<sup>2</sup> do miratohet me VKM. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu II. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve brenda zonave informale të miratuara”, pika 2/d si dhe nenin 27 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar.

- **Në 1 rast për dosjen nr. 759, datë 23.05.2005**, godinë banimi 5 kat +1 papafingo, pronar i ndërtimit pa leje: E.M.P, pa lëshuar leja e legalizimit, nga ALUIZNI Sarandë nuk është nxjerrë dosja për punim, e për pasojë nuk është proceduar me skualifikimin e objektit informal si dhe njoftimin e institucioneve kompetente për ndërtimin pa leje, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar, neni 27, si dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar, pasi objekti është ndërtuar në **Zonën “A” arkeologjike Sarandë**.

- **Në 1 rast për dosjen nr. 11, datë 15.09.2006**, leje legalizimi nr. 1040006, datë 22.10.2016, godinë banimi 1 kat, pronar i ndërtimit pa leje: S.I.K rezultoi se nga ALUIZNI Sarandë është proceduar me dhënien e lejes së legalizimit ndërkohë që çështja ka qenë objekt i procesit gjyqësor në shkallën e dytë, veprim ky që vjen në kundërshtim ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar, neni 26, ku përcaktohet se “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për të drejta mes vetë subjektit:

1. Nëse gjatë legalizimit ka mosmarrëveshje për raportet e pronësisë në objekt ose/dhe rreth përfshirjes së personave të tjerë, të cilët pretendojnë të drejta mbi parcelën ndërtimore, që legalizohet sipas këtij ligji, kjo mosmarrëveshje zgjidhet nga gjykata.

2. Gjatë shqyrtimit të konfliktit gjyqësor procedurat për legalizim të objektit pezullohen dhe rifillojnë sipas kushteve të këtij ligji, pasi vendimi gjyqësor të jetë i formës së prerë, me kushtin që ndërtimi pa leje të jetë vetëdeklaruar sipas afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.”

- **Në 1 rast** për dosjen nr. 918, datë 01.08.2006, I.F.Gj, në zonë të studiuar jashtë zonës informale, blloku H<sub>2</sub>, parcela nr. 36 në pronë publike, me sipërfaqe të zënë 510 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 125 m<sup>2</sup>, leje legalizimi nr. 47832, datë 19.09.2016, “Godinë banimi 2 kate”, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 408 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 148.5 m<sup>2</sup>, për banim 251.5 m<sup>2</sup>, nr. i kateve 2, pasuria nr. 27/26, kjo pronësi rezulton e regjistruar në ZVRPP Sarandë në pronësi shtet, sipas shkresës nr. 6177/1 të ZVRPP Sarandë, datë 11.07.2016, kthim përgjigje të shkresës së ALUIZNI-t nr. 1718, datë 28.06.2016, rezulton se parcela 10/37 sipas fragmentit të hartës bashkëlidhur shkresës prek pasurinë nr. 18/152, në zërin kadastral truall, me pronar shtet **pra 114 m<sup>2</sup>** më shumë së leja e legalizimit.

- **Në 1 rast për dosjen nr. 979, datë 17.06.2016**, leje legalizimi nr. 1040047, datë 17.05.2016, godinë e kombinuar 3 kat, pronar i ndërtimit pa leje: S. L.L, adresë bashkia Sarandë, komuna Ksamil zk. 2297, rezultoi se nga ALUIZNI Sarandë është proceduar me dhënien e lejes së

legalizimit kur kofirmimi i statusit juridik nga ZVRPP Sarandë cilëson se parcela bie mbi rrugë veprime këto në kundërshtim ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

- **Në 1 rast për dosjen nr. 422, datë 16.07.2013**, leje legalizimi nr. 1040192, datë 21.02.2017, shtesë në lartësi në objektin ekzistues 7 kat, në emër të **H.B.C**, me adresë lagje nr. 3, bashkia Sarandë zk 8642, rezulton se subjekti është pajisur me leje legalizimi pa marrë më parë miratimin nga banorët e pallatit, mungon akt noterial, për përdorimin e sipërfaqes së përbashkët, pasi terraca është pjesë e ambienteve të përbashkëta sipas përcaktimeve të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50 “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa”, pika 2.

- **Në 1 rast për dosjen nr. SR-45, datë 30.07.2015 nga shtetasja A. Sh.A, dhe nr. SR-169, datë 27.08.2015 nga shtetasi M.A.B**, leje legalizimi nr. 1040062, datë 04.08.2016, në dosje nuk administrohet deklaratë noteriale për përjashtimin nga leja e legalizimit, gjithashtu dhe miratimi i pjesëtarëve të tjerë për shtesën në lartësi pasi është pjesë e ambienteve të përbashkëta, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 27, pika “ë”, neni 29 dhe nenin 30 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar.

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për rishikim të lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

*Deri më datë 31.12.2017*

**13. Gjetje nga auditimi:** Në 14 raste ka rezultuar se ka mos përputhje të sipërfaqeve të katit përdhe me sipërfaqen për banim për sipërfaqen totale **prej 138.5 m<sup>2</sup>**, pasi pjesa e verandës është përfshirë tek sipërfaqja e banimit dhe jo në kondicionet e veçanta të lejes, ndërkohë që për sipërfaqen **285.9 m<sup>2</sup>** janë miratuar leje legalizimi me mospërputhje të sipërfaqeve të miratuara me VKM, veprime këto në kundërshtim me vetë lejen e legalizimit, si dhe pika 3, germa “a” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar .

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë të marrë masa, që për rastet në vijim të procedurave të legalizimit të plotësojë formularin e lejes së legalizimit në përputhje me kërkesat e ligjit, duke përfshirë pjesën e verandës tek kondicionet e veçanta të lejes, në përputhje me sipërfaqet e miratuara me VKM.

*Deri më datë 31.12.2017*

**14. Gjetje nga auditimi:** Në 10 raste nga ALUIZNI Sarandë janë mbajtur 2 akt-verifikime për dosjet në periudha të ndryshme **me diferencë kohe nga 1 vit deri në 3 vjet**, pa proceduar me dhënien e lejes së legalizimit që pas akt-kualifikimit të parë më mënyrë të paargumentuar, veprime këto që janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” .

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë, të marrë masa që më plane konkrete të shqyrtojë kërkesat për të zbatuar afatet ligjore për shqyrtimin e praktikave të legalizimit me qëllim rritjen e transparencës për publikun, si dhe respektimin e kërkesave të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar dhe VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave



e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

*Në vijimësi*

**15. Gjetje:** ALUIZNIT Sarandë, Titullari i Institucionit gjatë periudhës 01.03.2014-30.06.2017, nuk ka ngarkuar me urdhër të veçantë një person kompetent apo një grup specialistësh për shqyrtimin e ankesave, në asnjë nga dokumentet e punës të paraqitura për auditim nuk është adresuar përgjegjësia për shqyrtimin e ankesave, por ato i janë adresuar specialistëve përkatës rast pas rasti. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi dhe rakordimi ndërmjet sektorëve duke lënë pa adresuar problematikat e ngritura në ankesat e qytetarëve si dhe dhënien e zgjidhjeve ligjore të problemeve në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 9482 dt. 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizmin, integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Kodit të Procedurës Administrative, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar .

**15.1. Rekomandim:** Drejtoria ALUIZNI Sarandë, titullari i institucionit të marrë masa të caktojë me urdhër një grup pune për shqyrtimin e ankesave në përbërje të së cilit të ketë domosdoshmërisht një jurist dhe një specialist të sektorit të legalizimeve dhe hartografisë, si dhe të marrë masa të rrisë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve, duke adresuar problematikat e ngritura në ankesa dhe dhënien e zgjidhjeve ligjore të problemeve.

*Deri më datë 31.12.2017*

**16. Gjetje:** ALUIZNI Sarandë gjatë periudhës 01.03.2014-30.06.2017, nuk ka administruar dhe mbajtur një evidencë të saktë apo regjistër për shkresat e dërguara në ZVRPP Sarandë në lidhje me statusin e parcelave mbi të cilat janë ngritur ndërtimet pa leje, por shkresat administrohen bashkërisht me shkresat e tjera, si dhe pa caktuar me urdhër të brendshëm një person i cili duhet të mbajë evidencat për marrëdhëniet ALUIZNI-ZVRPP. Mungon informacioni i detajuar para vitit 2014, kjo edhe për shkak të mos marrjes dhe dorëzimit të detyrës me procesverbal nga punonjësit, në kundërshtim me pikën 13 të udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, çka ka sjellë si pasojë mungesën e një informacioni të saktë ndër vite për procesin e legalizimit .

**16.1. Rekomandim:** Drejtoria ALUIZNI Sarandë të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme për shkresat në lidhje me statuset juridike të pasurive, afatet e trajtimit të tyre, përgjigjet e dhëna nga ZVRPP si dhe problematikat e hasura në vazhdimësi, duke i shërbyer në këtë mënyrë mbarëvajtjes së procesit të legalizimit.

*Në vijimësi*

**17. Gjetje:** Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë së ALUIZNI-t Sarandë, nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (*vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI<sup>t</sup>, Sarandë*), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m<sup>2</sup> (*brenda/jashtë vijës së verdhë*), për efekt pagese të vlerës së truallit, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, e cila është pjese përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar. Por kjo është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultonin në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe

nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna, jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprime të cilat janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)" i ndryshuar, si dhe shkronja "f" dhe "g" e nenit 3, pika 1 e nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM<sup>së</sup> nr. 1620 datë 26.11.2008, **në 131 raste** gjatë periudhës 01.03.2014-30.06.2017, është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 29500 m<sup>2</sup>* (në total), **me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 21,199,301 lekë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të Shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve**, më hollësisht sipas Tabelës nr. 1- "*Sipërfaqe të zaptuara pjesë të parcelave ndërtimore të legalizuara*".

- Gjithashtu nga ALUIZNI-t Sarandë jo vetëm që nuk janë mbajtur evidenca mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, por nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkinë Sarandë, vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte, mungon deklarata noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore .

**17.1. Rekomandim:** Drejtoria ALUIZNI Sarandë të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, të njoftojë me shkresë institucionet vendore dhe ato kompetente si bashkinë Sarandë, duke vënë në dispozicion listën me sipërfaqe të lira, konkretisht për **131 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 29500 m<sup>2</sup>* (në total), **me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 21,199,301 lekë**, sipas Tabelës nr. 1- "*Sipërfaqe të zaptuara pjesë të parcelave ndërtimore të legalizuara*".

*Deri më datë 31.12.2017*

**18. Gjetje:** ALUIZNI Sarandë, në 2 raste për dosjet e legalizimit në favor të shtetasve Z.V dhe E.P, është proceduar me dhënien e lejes së legalizimit, pa u ankimuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe apelit, që ka marrë formë të prerë pas kalimit të afateve të ankimit, veprime këto që vinë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar; Rregulloren e brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e ALUIZNI-t", miratuar me urdher nr. 117, datë 14.7.2015 të ministrit të Zhvillimit Urban.

- Në 3 raste me paditës J.D, F. Xh dhe E.B nga ALUIZNI Sarandë nuk është nxjerrë urdher për pezullimin e procedurave të legalizimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, Neni 26- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për të drejta mes vetë subjektit, pika 2. Gjatë

shqyrtimit të konfliktit gjyqësor procedurat për legalizim të objektit pezullohen dhe rifillojnë sipas kushteve të këtij ligji, pasi vendimi gjyqësor të jetë i formës së prerë, me kushtin që ndërtimi pa leje të jetë vetëdeklaruar sipas afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji .

**18.1. Rekomandim:** Drejtoria ALUIZNI Sarandë të marrë masa që në çdo rast të ankimojë vendimet e gjyqësorit në të gjitha shkallët si dhe në ato raste kur procedurat për legalizim janë objekt i proceseve gjyqësore të marrë masa e të nxjerrë urdhër për pezullimin e procedurave të legalizimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006.

*Në vijimësi*

**19. Gjetje:** Nga shqyrtimi dhe verifikimi i ankesës së shtetas N.Xh. S, administruar në KLSH me nr. 397 prot, datë 14.04.2017 e cila pretendon për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nga ALUIZNI Sarandë në pranimin e aplikimit për legalizimin e objektit informal ndërtuar nga shtetasi A.N(K...), mbi truallin e tyre, **u konstatua se** nga ALUIZNI Sarandë nuk janë zbatuar procedurat administrative në përpilimin e akteve të ndërmjetme procedurale sipas afateve ligjore, nuk është respektuar afati prej 60 ditësh nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit në terren deri në marrjen e Vendimit për skualifikimin e objektit sipas kërkesave të pikës 8 të VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

- Vendimi gjyqësor nr. 491, datë 15.11.2011 i gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili ka vendosur ndryshimin e Vendimit nr. 570, datë 29.04.2011 të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, si dhe detyrimin e palës së paditur A.N të lirojë dhe dorëzojë paditësve sipërfaqen e truallit prej **398 m<sup>2</sup>**, është marrë më parë në kohë nga aplikimi i bërë nga shtetasi A.H.K me nr. 12 prot, datë 12.06.2013 për legalizimin e objektit informal, pra gati dy vjet më parë.

- Sa sipër në kushtet kur për këtë objekt është paraqitur ankesë nga trashëgimtarët Xh... dhe kjo çështje është ende objekt i një procesi gjyqësor. ALUIZNI Sarandë nuk duhet të kryej asnjë veprim për këtë dosje deri në përfundimin e procesit gjyqësor .

**19.1. Rekomandim:** Drejtoria ALUIZNI Sarandë, titullari i institucionit të nxjerrë urdhër për pezullimin e procedurave të legalizimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 26- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për të drejta mes vetë subjektit, pika 2. *Gjatë shqyrtimit të konfliktit gjyqësor procedurat për legalizim të objektit pezullohen dhe rifillojnë sipas kushteve të këtij ligji, pasi vendimi gjyqësor të jetë i formës së prerë, me kushtin që ndërtimi pa leje të jetë vetëdeklaruar sipas afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.*

*Menjëherë*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqësorit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

**Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **9 raste me vlerë 927,504 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje:** Në lëshimin e lejes së legalizimit për 9 raste është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, trajtuar me hollësisht si më poshtë:

- **Dosja nr. 865**, datë 22.03.2005, me kërkues A.Zh me leje legalizimi nr.1040227, datë 18.10.2016, mungon tarifa e shërbimit për ndërtimin informal dy kate në vlerë **16,000 lekë**;

- **Dosja nr. 73**, datë 17.02.2005 me kërkues I& A.K.B , me leje legalizimi nr. 1040087, datë 11.08.2016, nga rilogaritjet del se duhet të paguante për sipërfaqen prej 1230 m<sup>2</sup>, ndërsa në fakt janë kryer pagesat për sipërfaqen 1166.2 m<sup>2</sup>, pra me një diferencë prej 63.80 m<sup>2</sup> ose në **vlerë 41,780 lekë**;

- **Dosja nr. 935/1**, datë 16.10.2014, me kërkues L.Ç me leje legalizimi nr.1040332, datë 01.12.2016, nuk është llogaritur dhe kryer pagesa **8,000 lekë** për çdo kat të ndërtimit e barabartë me 48,000 lekë, si dhe nuk është llogaritur penalteti, duke i është shkaktuar një dëm buxhetit të shtetit për fondin e kompensimit në shumën **772,734 lekë**;

- **Dosja nr. 696/19**, datë 18.10.2006, me kërkues R.F me leje legalizimi nr. 52958, datë 21.11.2016, “Godinë banimi 1 kat”, me adresë Ksamil, Sarandë, ZK nr. 2297, nuk janë llogaritur gjoba sanksionet e zbatueshme për mos zbatim afati për vlerën **10,000 lekë** dhe tarifë shërbimi në vlerën **4,000 lekë**;

- **Dosja nr. 802/77**, datë 24.11.2006, me kërkues A.Sh me leje legalizimi nr. 1040028, datë 27.01.2016, nuk janë llogaritur gjoba sanksionet e zbatueshme për mos zbatim afati për vlerën **10,000 lekë**;

- **Dosja nr. 43**, datë 06.11.2006, leje legalizimi nr. 688998, datë 09.10.2015, pronar i ndërtimit pa leje: J.S.Zh, nuk ka paguar kamatvonesën në vlerën **10,000 lekë**;

- **Dosja nr. SR-45**, datë 30.07.2015 nga shtetasja A.Sh. A, dhe nr. SR-169, datë 27.08.2015 nga shtetas M.A. B, leje legalizimi nr. 1040062, datë 04.08.2016, nuk administrohet pagesa për tarifën e shërbimit në vlerën **8,000 lekë**;

- **Dosja nr. 737/6**, datë 31.10.2006, leje legalizimi nr. 48553, datë 16.02.2016, godinë banimi 1 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: A. M.L, nuk ka paguar kamatvonesën në vlerën **2,900 lekë**;

- **Dosja nr. 331/20, datë 17.07.2013, dhe nr. 899/1, datë 14.10.2014**, leje legalizimi nr. 1040062, datë 23.06.2016, pronar i ndërtimit pa leje: N., O, V, R. Th.M dhe V dhe J.Dh, nuk administrohet pagesa për tarifën e shërbimit për 6 kate banese si objekt i dytë në vlerën **48,000** .

**1.1- Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Sarandë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e **vlerës prej 41,780 lekë** nga subjekti I & A.B për si penaltet, nga subjekti L.Ç **për vlerën prej 772,734 lekë** si penaltet dhe **vlerën prej 48,000 lekë** tarifa shërbimi, subjekti A.Sh **për vlerën prej 14,000 lekë** nga kjo 10,000 lekë gjoba dhe 4,000 lekë tarifë shërbimi, subjekti R.F **për vlerën prej 10,000 lekë** gjobë dhe subjekti A.Zh **për vlerën prej 16,000 lekë** tarifë shërbimi, për subjektin J.S.Zh kamatvonesë në vlerën **10,000 lekë**, **për subjektin A..Sh.A dhe M.A. B**, pagesa për tarifën e shërbimit në vlerën **8,000 lekë**, **për subjektin Andon Muhamet Lile** kamatvonesa në vlerën **2,900 lekë** dhe për subjektin N, O, V, R.Th. M dhe V dhe J.Dh, pagesa për tarifën e shërbimit për 6 kate banese si objekt i dytë **në vlerën 48,000**.

*Deri më datë 31.12.2017*

## C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit Rajonal të ALUIZNI Sarandë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me shkrim”** deri në **“Largim nga puna”**, për këta punonjës:

### I. “Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 1 punonjës si më poshtë:

**1. M.K.**, me detyrë ish-përgjegjëse e sektorit të çështjeve të pronësisë, aktualisht specialiste;

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit:

-Për mungesën e dokumentacion shkresor për skualifikimin ose jo të 45 objekteve të ndërtuara në zonën historike, turistike, arkeologjike A dhe B si dhe për 97 objekte të ndërtura në zonën e mbrojtjes mjedisore “A” Parku kombëtar i Butrintit miratuar me VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen kompleksit ligatinor të Butrintit- Park kombëtar” ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.02.2013, si dhe mos informimit të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore, veprime në kundërshtim me neni 38 “Dhënia e lejes së legalizimit” dhe nenin dhe 39, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 me ndryshime, për rikthimin në arshivë të 1853 dosje objektsh, pa u dokumentuar më parë përfundimin apo jo të procedurave të terrenit dhe dokumentare, pa u dokumentuar arsyet e rikthimit në arshivë, dhe pa u selektuar më parë si subjekte që duheshin skualifikuar apo jo, për mos respektimin e afati të shqyrtimit të dosjeve të nxjerra nga arkiva, duke shkaktuar vonesa nga 6 muaj deri në 1 vit;

- Mos respektimi i afateve ligjore për dërgimin e dokumentacionit të lejes së legalizimit në ZVRPP Sarandë në kundërshtim me kërkesat e Vendimit nr. 1095 date 28.12.2015 *“Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”*;

- Mos mbajtjen e evidencës mbi sipërfaqet e lira në pronësi Shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, mos marrjen masave për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkinë Sarandë dhe Njësit e tjera të vetëqeverisjes vendore, vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte.

- Në **17 raste** nga verifikimi materialit dixhital e hartografik, gent plan, ortofoto rezulton se nga Drejtoria e ALUIZNI-t Sarandë janë pajisur me leje legalizimi objekte të ndërtuara brenda zonës së mbrojtjes mjedisore “A” Parku Kombëtar i Butrintit miratuar me VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen kompleksit ligatinor të Butrintit- Park Kombëtar” ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.02.2013, administruar në ALUIZNI Sarandë me nr. 152 prot, datë 28.02.2013, për pasojë këto objekte nuk duhet të kualifikoheshin dhe nuk duhet të procedohej me dhënien e lejes së legalizimit

- Për rikthimin në arshivë të 1853 dosje objektsh pa u dokumentuar mbi përfundimin apo jo të procedurave të terrenit dhe dokumentare, pa u dokumentuar arsyet e rikthimit në arshivë, dhe pa u selektuar më parë si subjekte që duheshin skualifikuar apo jo, veprime këto që vinë në kundërshtim me pikën 5 të nenit 2, nenin 38 dhe nenin 39-*Përfundimi nga Legalizimi*, të ligjit nr. 9482, datë

03.04.2006 me ndryshime, Kapitulli IV i VKM nr. 280, datë 01.04.2015, urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 ndryshuar me 954, datë 25.11.2015 .

## **II- Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në “Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 7 punonjës si më poshtë:**

1. **A.Th**, me detyrë specialist terreni;
2. **A. T**, me detyrë specialist terreni;
3. **D. Gj**, me detyrë specialiste terreni,
4. **L,P**, me detyrë specialist jurist nga data 25.05.2016-në vazhdim
5. **E.Y**, me detyrë specialist terreni;
6. **K.K**, me detyrë ish-përgjegjëse sektorit kalimit të pronësisë, aktualisht specialiste terreni;
7. **I.N**, me detyrë ish-specialiste terreni, aktualisht përgjegjëse sektorit kalimit të pronësisë.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:

- Për rikthimin në arshivë të 1853 dosje objekte pa u dokumentuar mbi përfundimin apo jo të procedurave të terrenit dhe dokumentare, pa u dokumentuar arsyet e rikthimit në arshivë, dhe pa u selektuar më parë si subjekte që duheshin skualifikuar apo jo, veprime këto që vinë në kundërshtim me pikën 5 të neni 2, neni 38 dhe neni 39-*Përrjashtëmi nga Legalizimi*, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, Kapitulli IV i VKM nr. 280, datë 01.04.2015, urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 ndryshuar me 954, datë 25.11.2015;

- Mos respektimi i afateve ligjore për dërgimin e dokumentacionit të lejes së legalizimit në ZVRPP Sarandë në kundërshtim me kërkesat e Vendimit nr. 1095 date 28.12.2015 *“Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”*;

- **Në 75 raste** *“Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”*, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë por pa përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve, veprime këto në kundërshtim me manualin *“Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”*, miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 *“Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”* i ndryshuar.

- Në 75 raste në dosje nuk administrohet ortofoto dixhitale ose një dokument tjetër nga një burim alternativ, pra nuk ka dokumentacionin i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, veprim në kundërshtim me VKM nr. 589, date 10.09.2014 *“Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”* pika 3 ku përcaktohet: - *“Verifikimi i ndërtimeve informale, brenda periudhave kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhet nëpërmjet të paktën njëres prej formave të mëposhtme:... Dokumentacioni, i cili*

*provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit.”*

- Në 70 raste gent plani i hartuar nuk ka të përcaktuar hyrjen në parcelë por vetëm hyrjen në ndërtesë sipas shenjave konvencionale, në kundërshtim me shkresën nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (gentpani dhe planimetrisë) të objektit që legalizohet”, pika 1- Procedura për hartimin e materialeve grafike dhe pika 2- Modeli i paraqitjes së gen-planit.

- Në 14 raste ka rezultuar se ka mos përputhje të sipërfaqeve të katit përdhe me sipërfaqen për banim për sipërfaqen totale prej 138.5 m<sup>2</sup>, pasi pjesa e verandës është përfshirë tek sipërfaqja e banimit dhe jo në kondicionet e veçanta të lejes, ndërkohë që për sipërfaqen 285.9 m<sup>2</sup> janë miratuar leje legalizimi me mospërputhje të sipërfaqeve të miratuara me VKM, veprime këto në kundërshtim me vetë lejen e legalizimit, si dhe Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar; si dhe pika 3, germa “a”.

- Në 10 raste nga ALUIZNI Sarandë janë mbajtur 2 akt-verifikime për dosjet në periudha të ndryshme me diferencë kohe nga 1 vit deri në 3 vjet, pa proceduar me dhënien e lejes së legalizimit që pas akt-kualifikimit të parë më mënyrë të paargumentuar, veprime këto që vinë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

### **III- Masa “Vërejtje me shkrim” për 4 punonjës si më poshtë:**

1. **A.K**, me detyrë ish-përgjegjës i sektorit të terrenit 25.05.2016 e vazhdim;
2. **M.N(C)**, me detyrë përgjegjëse e sektorit të hartografisë nga data 04.1.2017-në vazhdim;
3. **E.O**, me detyrë ish-specialist i verifikimit në terren, aktualisht përgjegjës i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse nga data 04.09.2015-në vazhdim;
4. **M.L**, me detyrë specialiste terreni;

Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në miratimin e lejeve të legalizimit pasi:

- Për rikthimin në arshivë të 1853 dosje objekte pa u dokumentuar mbi përfundimin apo jo të procedurave të terrenit dhe dokumentare, pa u dokumentuar arsyet e rikthimit në arshivë, dhe pa u selektuar më parë si subjekte që duheshin skualifikuar apo jo, veprime këto që vinë në kundërshtim me pikën 5 të nenit 2, nenin 38 dhe nenin 39-*Përrjashtimi nga Legalizimi*, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, kapitulli IV i VKM nr. 280, datë 01.04.2015, urdhrin nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 ndryshuar me 954, datë 25.11.2015;

- Për mos dërgimin në kohë të shkresave për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe mos rakordimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –*“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”* si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –“ c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 i ndryshuar.

- Në **14 raste** ka rezultuar se ka mos përputhje të sipërfaqeve të katit përdhe me sipërfaqen për banim për sipërfaqen totale prej 138.5 m<sup>2</sup>, pasi pjesa e verandës është përfshirë tek sipërfaqja e banimit dhe jo në kondicionet e veçanta të lejes, ndërkohë që për sipërfaqen 285.9 m<sup>2</sup> janë miratuar leje legalizimi me mospërputhje të sipërfaqeve të miratuara me VKM, veprime këto në kundërshtim me vetë lejen e legalizimit, si dhe germa “a” e pikës 3 e ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar

**IV- Për 2 punonjës aktual, nuk propozojmë masë pasi shkalla e shkeljeve në raport me pasojat në mirëfunksionimin e institucionit, nuk është në nivelin për propozim masë disiplinore, si më poshtë:**

1. **S.B**, me detyrë specialist terreni;
2. **A.P** me detyrë përgjegjëse e sektorit të protokoll/arkivë nga data 10.10.2015-në vazhdim.

**Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.**

V. Për **10** ish punonjësit, që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte nga **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”** dhe **“Largim nga puna (zgjidhje e kontratës)”**, përkatësisht për punonjësit si vijon:

1. **O.C**, me detyrë ish-drejtor i ALUIZNI-t Sarandë nga data 01.09.2015-07.01.2016;
2. **B.D**, me detyrë ish-drejtor i ALUIZNI-t Sarandë nga data 11.01.2016-05.12.2016;
3. **V.M**, me detyrë ish-përgjegjës i sektorit të legalizimit nga data 04.09.2015-08.08.2016;
4. **R.D**, me detyrë ish-përgjegjës i sektorit të legalizimit nga data 25.05.2016- 31.12.2016;
5. **M.Zh**, me detyrë ish-specialist i sektorit të hartografisë nga data 04.09.2015-05.01.2016;
6. **V.K**, me detyrë ish drejtor;
7. **J.A**, me detyrë ish-specialiste terreni;
8. **Q.Ç**, me detyrë ish-përgjegjës zyre;
9. **K.Premti**, me detyrë ish-specialiste terreni;
10. **L.C**, me detyrë ish-përgjegjës i sektorit të legalizimit;

**D. INDICIE PËR KALLËZIM PENAL:**

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika “gj” e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", **sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik rast pas rasti** nga ana e departamentit juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit **për shkeljet e konstatuara dhe pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Adutimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal të dërgohet për indicie i gjithë materiali i përgatitur, duke përcaktuar dhe emrat e nëpunësve përgjegjës..**



Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**